



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.579/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqaj, duke vendosur lidhur me apelin e Arbreshë Kryeziu Hyseni nga Gjilani, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860-2021, të datës 04.03.2021, për shkak të bartjes së votave të një kandidat tjetër në vendvotimin 0402X/01R në Gjilan, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet i bazuar apeli me numër Anr.579/2021 i datës 04.03.2021, e parashtuara nga Arbreshë Kryeziu Hyseni nga Gjilani, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me numër 860-2021 i datës 04.03.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme, për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 14.02.2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në vendvotimin: 0402X/01R në Gjilan.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me numër Anr.579/2021 të datës 04.03.2021, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Arbreshë Kryeziu Hyseni ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.579/2021, me të cilën pretendon se në vendvotimin me numër 0402X/01R në Gjilan, në përshkrimin total të votave në FPR është bërë një gabim nga ana e personit që e ka bërë përshkrimin. Parashtruesja e apelit pretendon që votat e saj që në total janë 118 i janë përshkruar kandidatit tjetër nga Lëvizja Vetëvendosje, Arbër Rexhaj që është me renditje menjëherë pas numrit tim. Këtë ma ka konfirmuar edhe komisionerja e Lëvizjes Vetëvendosje në atë klasë, Uratë Krasniqi.

Si dëshmi për pretendimet e saj ka bashkangjitur në apel kopjen e listës së rezultateve përfundimtare të kandidatëve të subjekteve politik në vendvotimin 0402X/01R në Gjilan, të publikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Arbreshë Kryeziu Hyseni, brenda afatit ligjor, ka parashtruar Apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që vendvotimin 0402X/01R në Gjilan, të rishqyrtohet dhe të konstatohet nëse ka parregullsi apo jo, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, pas shqyrtimit të apelit Anr.579/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje Arbreshë Kryeziu Hyseni është i bazuar. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se gjatë bartjeve të votave në formularët FPR, kjo është bërë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me pa rregullsi nga ana e komisionerëve të cilët kanë bërë bartjen e këtyre votave. Andaj nga kjo gjendje e tillë faktike paneli vendosi që vendvotimin 0402X/01R në Gjilan, sa i përket kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të dërgohet në rinumërim.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 579/2021 më datën 05.03.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.